

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-6370  
Më 21.5.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës për formimin e komisionit për pritjen e kryetarit të Bashkisë së Bingenit me stafin e tij si dhe mbulimin e shpenzimeve të akomodimit të tyre, kryetari i Komunës, me 21 maj 2013, mori këtë

### AKTVENDIM

I. Formohet dhe emërohet Komisioni për pritjen e kryetarit të Bashkisë së Bingenit me stafin e tij në Komunën e Prizrenit. Anëtarë të këtij komisioni, emërohen:

- a. Arjeta Nezaj,
- b. Kujtim Gashi, dhe
- c. Visar Islamaj.

II. Detyrat e Komisioni nga pika I e këtij Aktvendimi janë: Të organizoj dhe koordinoj pritjen zyrtare të delegacionit të Bashkisë së Bingenit, të angazhohet që pritja dhe vizita e delegacionit të lartcekur të bëhet sipas planifikimit zyrtar që është e përcaktuar nga ana e kryetarit të Komunës së Prizrenit. Ky komision mund të ndërmerr edhe veprime të tjera që janë konformë rregullave të Protokollit zyrtar.

III. Për pritjen e kryetarit të Bashkisë së Bingenit me stafin e tij lejohen mjetet e nevojshme financiare për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit dhe ushqimit. Mjetet lejohen nga buxheti i Komunës-pozicioni i subvencioneve dhe mallrave dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.

IV. Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës, Zyra për Marrëdhënie me Publikun, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen: Drejtoria e Administratës, Zyra për Marrëdhënie me Publikun, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të emëruarit. dhe Arkivi.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-6217  
Më 21.5.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 21.5.2013, me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin me elemente betoni të disa rrugëve lokale dhe kanalizimeve me participim, në Komunën e Prizrenit, dhe mori këtë:

### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 13.5.2013, për lejimin e ndërtimit me elemente betoni të disa rrugëve lokale dhe kanalizimeve me participim, në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për ndërtimin e:

1. Kanalizimit në fshatin Piran,
2. Rrugëve kanalizimit në lagjen "Kurilla" ( rr. "Agim Shala", rr. "Mehmet Çik", rr. "Selman Riza", dhe kanalizimi atmosferik në rr. "Kurilla");
3. Rrugës lokale në fshatin Caparc, dhe
4. Kanalizimit në rr. "Hysni Morina.

Për realizimin e këtyre projekteve, Komuna e Prizrenit do të participojë me 70 % të vlerës së projektit, ndërsa komuniteti me 30 %.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-6217  
Më 21.5.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.5.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë rreth lejimit të shpalljes së tenderit për furnizim me inventar të nevojshëm për nevojat e QKMF-së, QMF-ve, AMF-ve, dhe të Urgjencës, dhe mori këtë

### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë rreth lejimit të furnizimit me inventar të nevojshëm për nevojat e QKMF-së, QMF-ve, AMF-ve dhe objektet e tjera shëndetësore (Urgjenca), kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prizren  
Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-6371  
Më 21.5.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr. 03/L-204 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 04/2011 si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, kryetari i Komunës, më 21 maj 2013, miratoi këtë:

## AKTVENDIM

I. Formohet dhe emërohet Komisioni për vlerësimin e patundshmërive, caktimin e bazës tatimore për tatimin në pronë, rishikimin e zonave tatimore dhe hartimin e projekt rregullores mbi aplikimin e Tatimit në Pronë për vitin 2014. Anëtarë të këtij komisioni, emërohen:

- a. Ismet Rama nga DEF,
- b. Abdullah Smaili, nga DEF,
- c. Mehmedali Ramadani, nga DEF,
- d. Zana Belloda, nga DUPH,
- e. Ferat Sezairi, nga DGJK,
- f. Sefer Avduti, nga Sektori i Pronës, dhe
- g. Gursel Skenderi nga Sektori i pronës.

Komisioni në mbledhjen e parë do ta zgjedhë kryesuesin e komisionit.

II. Detyrat e Komisioni nga pika I e këtij Aktvendimi janë të parapara në Ligjin Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr. 03/L-204 dhe Udhëzimit Administrativ për caktimin e vlerës së pronës së paluajtshme dhe standardet e vlerësimit nr. 04/2011, si dhe në nenin I të këtij Aktvendimi.

III. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtoria për Ekonomi dhe Financa dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, të emëruarit dhe Arkivi.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-6372  
Më 21.5.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, rreth lejitimit të udhëtimit zyrtar për në Republikën e Shqipërisë të Zenel Ahmetit, zyrtar komunal, kryetari i Komunës, më 21 maj 2013, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, për lejitimin e udhëtimit zyrtar të Zenel Ahmetit, zyrtar komunal, për në Elbasan të Republikës së Maqedonisë, me qëllim të pjesëmarrjes në punëtorinë që ka të bëjë me shkëmbimin e praktikave lidhur me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor të zyrtarëve komunal. Punëtorija do të mbahet nga data 19 maj deri me 21 maj 2013, kështu që për këtë qëllim i lejohej udhëtimi zyrtar i të lartcekurit.

### Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtorija e Ekonomisë dhe Financave.

### Neni 3

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtorija e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

### Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-6374

Më 21.5.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 108 të Ligjit për Procedurën Administrative, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për plotësimin dhe ndryshimin e Konkluzionit nr. 01/06-5034 të datës 23.4.2013, kryetari i Komunës, më 21 maj 2013, miratoi këtë:

## V E N D I M

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, për ndryshimin dhe plotësimin e Konkluzionit nr. 01/06-5034, të datës 23.4.2013, që ka të bëjë me lejmimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e dy shtëpizave për roje të pyjeve, kështu që në vend të fjalës “ndërtim me material të fortë të dy shtëpizave” duhet të jetë “ndërtim me material të fortë të një shtëpize për roje të pyjeve dhe atë në Koretnik -1”.

II. Pjesët e tjera të Konkluzionit nr. 01/06-5034 të datës 23.4.2013, mbesin të pandryshuara.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë vendim të njoftohen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

The image shows an official circular stamp of the Municipality of Prizren, Kosovo. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E KOSOVËS", "KOMUNA E PRIZRENIT", "OPSTINA PRIZREN", "Bujqësi dhe Zhvillim Rural", and "Kryetari i Komunës". A handwritten signature in black ink is written over the stamp.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-6217  
Më 21.5.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.5.2013 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik rreth lejitimit të shpalljes së tenderit për realizimin e disa punimeve të Kampi Turistik, dhe mori këtë

### KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik rreth lejitimit të realizimit të disa punimeve të Kampi Turistik (ndriçimi, gardhi rrethues, mbëltimi i drunjve dekorativ, etj), kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

The image shows an official circular stamp of the Municipality of Prizren, Kosovo. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E KOSOVËS", "KOMUNA E PRIZRENIT", "KOMUNALiteti", "PRIZREN", "KOSOVA", "REPUBLICA OF KOSOVO", "MUNICIPALITY OF PRIZREN", "PRIZREN", "KOSOVO". Overlaid on the stamp is a handwritten signature in black ink.

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-6217  
Më 21.5.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.5.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik rreth lejimit të shpalljes së tenderit për rregullimin e shtegut për ecje dhe rregullimin e ambientit prej stacionit tek Marashi e deri te parkingu afër Kompleksit “Andrra”, dhe mori këtë

### KONKLuzion


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik rreth lejimit të rregullimit të shtegut për ecje dhe rregullimin e ambientit prej stacionit tek Marashi e deri te parkingu afër Kompleksit “Andrra”, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja





REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-6217  
Më 21.5.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.5.2013 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të datës 14.5.2013, rreth lejitimit të shpalljes së tenderit për furnizim me material ndërtimor për ndërtimin dhe meremetimin e disa shtëpive të familjeve në nevojë sociale, dhe mori këtë

### KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, i datës 14.5.2013, rreth lejitimit të furnizimit me material ndërtimor me qëllim të ndërtimit dhe meremetimit të disa shtëpive të familjeve në nevojë sociale të Komunës së Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Operatori ekonomik si fitues i tenderit për furnizim me material ndërtimor do të bëjë shpërndarjen e materialit ndërtimor deri te përfituesi i materialit (familja përfituese).

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punë dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramëdan Muja



The stamp is circular with the text 'REPUBLIKA E KOSOVËS' at the top and 'KOMUNA E PRIZRENIT' at the bottom. Inside the stamp, it says 'DREJTORIA E EKONOMISË DHE E FINANCËVE'. A handwritten signature is written over the stamp.

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-6375  
Më 21.5.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e mjeteve financiare për Shoqatën e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, kryetari i Komunës më 21 maj 2013, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e mjeteve financiare për Shoqatën e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së lidhur me realizimin e projektit që ka të bëjë me dërgimin e nënave dhe grave të dëshmorëve në pushime verore (rekreacion), kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të lartcekura, lejohen mjetet e nevojshme financiare në shumën 5000 €.

Shoqata e lartcekur duhet të jep me shkrim një raport para Drejtorisë përkatëse lidhur me realizimin e projekti.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.


Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, ShFD të UÇK-së, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja





REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-6376  
Më 21.5.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, për lejimin e mjeteve financiare për shënimin e Ditës së Zjarrfikësve, kryetari i Komunës më 21 maj 2013, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, i datës 17.5.2013, për lejimin e mjeteve financiare për shënimin e Ditës së Zjarrfikësve që organizohet me 25.6.2013, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet financiare në shumën prej 1600 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-6217  
Më 21.5.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Turqi dhe pagesës së mëditjeve për Nexhat Çoçajn, drejtor i DASH-së, kryetari i Komunës, më 21 maj 2013, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Nexhat Çoçajn, drejtor i DASH-së, për në Antalya të Republikës së Turqisë, me qëllim të pjesëmarrjes në projektin studimore që ka të bëjë me menaxhimin e shkollës sipas modelit Amerikan. Takimet do të mbahen nga data 11 maj deri me 18 maj 2013, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurin.

### Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

### Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-6377  
Më 21.5.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Çështje Gjinore për lejimin e mjeteve financiare për organizimin e programit festiv "Olimpiada e fëmijëve-Prizreni 2013", kryetari i Komunës, më 21 maj 2013, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyra për Çështje Gjinore rreth lejimit të mjeteve financiare për organizimin e programit festiv "Olimpiada e fëmijëve-Prizreni 2013" i cili organizohet për nder të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve -1 Qershori, kështu që për realizimin e këtij projekti lejohen mjetet në shumën prej 1500 €.

Ky projekt do të realizohet nga Zyra për Çështje Gjinore në bashkëpunim me OJQ "Për një mendje të shëndoshë".

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Çështje Gjinore dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Çështje Gjinore, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-6217  
Më 21.5.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.5.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik rreth lejimit të shpalljes së tenderit për një film promocional dhe spote televizive për promovimin e turizmit, dhe mori këtë

### K O N K L U Z I O N


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik rreth lejimit të realizimit të një projekti-film promocional i quajtur "Mirë se vini në Prizren" dhe të spoteve televizive për promovimin e turizmit në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja





REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-6378  
Më 21.5.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas kërkesës së Organizatës Komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës në Prizren, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare, kryetari i Komunës më 21 maj 2013, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet kërkesa e Organizatës Komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës në Prizren për mbështetje financiare për organizimin e tubimit tradicional të pensionistëve dhe invalidëve të punës në Prizren që do të organizohen në Prevallë gjatë muajit qershor 2013, dhe për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën 1000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-6379  
Më 21.5.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas kërkesës së Valentina Kashnjeti, për lejimin e mjeteve për mbështetje, kryetari i Komunës më 21 maj 2013, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet kërkesa e Valentina Kashnjetit, e evidentuar si rast sociale, për mbështetje me mjete financiare, me qëllim të furnizimit me gjëra ushqimore, higjienike dhe mjekësore për familjen e saj, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën prej 2000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Drejtoritë tjera komunale.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Drejtoritë tjera komunale, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-6217  
Më 21.5.2013

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të propozimit të Drejtorisë së Administratës, rreth lejimit të shpalljes së tenderit për meremetimin e Zyrës së Gjendjes Civile në fshatin Reçan, dhe mori këtë

### KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës rreth lejimit të meremetimit të Zyrës së Gjendjes Civile në fshatin Reçan, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja